



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-01/21
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	28.12.2021
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së parë (1) të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2021 me datë: 28.12.2021, në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. **Shpejtim Gacaferi**: i cili në fillim përshëndeti kryetarin e Komunës: z. Ruzhdi Shehun, komandin e policisë z. Rasim Sylaj, bashkëvendësit nga diaspora që ishin prezent, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

z. Shpejtim Gacaferi: E kaloi fjalën të Kryetari i Komunës z. Ruzhdi Shehu.

z. Ruzhdi Shehu: fillimisht përshëndeti Kryesuesin e Kuvendit Komunal, të gjithë pranishmit, z. Rasim Sylaj Komandant i Policisë në Junik, përfaqësuesit nga mërgata, anëtarët e Kuvendit Komunal.

z. Ruzhdi Shehu fillimisht shfrytëzoi rastin të përshëndes fillimin e punimeve të legjislaturës së re pas dhënies së betimit, se pari ju urojë shëndet dhe punë të mira për qytetaret e Komunës së Junikut, siç është edhe detyra juaj si anëtarë të Kuvendit Komunal, që jeni të zgjedhur nga qytetarët e Junikut, bashkëpunimi nuk do të mungojë nga unë asnjëherë me ju si kuvendar, por kërkoj edhe nga ju që të kemi bashkëpunim për punët dhe interesat e përgjithshme për qytetarët e Junikut.

Mbledhja u organizua duke respektuar udhëzimet e IKSHPK-së.

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK
5. Ermelinda Lolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Xhemë Tofaj- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi- Anëtare, LVV

Mungoi:

Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV

Rendi i ditës

1. Dhënja e betimit të anëtareve të ri të Kuvendit (znj. Lirjeta Shehu dhe Xhemë Tofaj),
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar (mbledhja konstituive),
3. Caktimi i përfaqësuesve të subjekteve politike pjesëmarrëse në K.K. Junik,
4. Shqyrtimi i propozim Vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit,
5. Të ndryshme.

z. Shpejtim Gacaferi: E hapi diskutimin sa i përket rendit të ditës. A dëshiron dikush të merr fjalën. Nuk kishte diskutime . Dhe e hodhi në votim këtë rend të ditës.

Nga 11 prezent, për ishin 11, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të ri të Kuvendit (znj. Lirjeta Shehu dhe Xhemë Tofaj)

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, nga KQZ kemi pranuar dy vendime të cilët sipas radhitjes së numrit të votave që kanë marrë në zgjedhje vinë pasues **znj. Lirjeta Shehu nga LDK dhe z. Xhemë Tofaj nga LVV** do të jenë anëtarë të Kuvendit Komunal .

z. Shpejtim Gacaferi: Ftoj për ta bërë betimin si anëtarë të Kuvendit Komunal, **znj. Lirjeta Shehu dhe z. Xhemë Tofaj**, dy anëtarët e ri të Kuvendit Komunal e bënë betimin sipas procedurave ligjore.

Pika e dytë e rendit të ditës

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar (mbledhja konstituive),

z. Shpejtim Gacaferi: Për pikën e dytë Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar (mbledhja konstituive), kisha propozuar që të hiqet prej rendit të ditës pasi që nuk kemi arrit ta përgatitim, por do të jetë i gatshëm në mbledhjen e radhës në muajin janar.

Pika e tretë e rendit të ditës

3. Caktimi i përfaqësuesve të subjekteve politike pjesëmarrëse në K.K. Junik,

z. Shpejtim Gacaferi: Po fillojmë me grupin e LDK-së për propozimin për Shef të grupit. I dha fjalën **znj. Ermelinda Lllolluni**.

znj. Ermelinda Lllolluni : Në emër të grupit të LDK-së propozoi **z. Sadri Krasniqin** si Shef të grupit

z. Zenel Maloku: Në emër të grupit të AAK-së propozoi **z. Leonard Lllolluni** për Shef të grupit.

znj. Eliza Pepshi: Në emër të grupit të LVV-së propozoi **z. Lulzim Gacaferi** për Shef të grupit.

z. Shpejtim Gacaferi: Kemi 3 propozime nga LDK, **z. Sadri Krasniqin**, nga AAK , **z. Leonard Lllolluni** dhe nga LVV **z. Lulzim Gacaferin**, e hedhi në votim.

Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e katërt e rendit të ditës

4. Shqyrtimi i propozim Vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit,

z. Shpejtim Gacaferi: E hapi diskutimin sa i përket kësaj pike. Iu dha fjalën në emër të grupit.

z. Sadri Krasniqi: Si grup pajtohem me orarin e mbledhjeve në ora 10:00.

z. Leonard Lllolluni: Ne si grup i AAK-së pajtohem me orarin e mbledhjeve në ora 10:00.

Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e pestë e rendit të ditës

5. Të ndryshme,


z. Shpejtim Gacaferi: sa i përket kësaj pike a ka diskutime: **z. Zenel Maloku** unë e kom një propozim, kur të vjen procesverbali se cila fletë të ketë numrat e vendosur, dhe tjetra, mos të përsëriten gabime të ndryshimi i fjalës si ne te kaluarën .

z. Shpejtim Gacaferi: E shpalli të mbyllur mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal në Junik, shfrytëzojë rastin t'iu urojë festat e fund vitit ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:00.

Procesmbajtësi:

z. Arton Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

